



**GRUPI PËR STUDIME
MJEKËSORE DHE EKOLOGJIKE
GROUP FOR MEDICAL
AND ECOLOGICAL STUDIES**

www.gsmesite.org

**Rekomandime për parandalimin e përhapjes së Gripit
Pandemik H1N1 në shkollat fillore dhe të mesme në
Republikën e Kosovës**

DHJETOR 2009

Adr. Gustav Mayer A1/5 Prishtinë, Kosovë.
Tel. +377 44 621 621 / +386 49 372 090 / +381 38 226 412

www.gsmesite.org

Kontrulli i higjienës personale

Gripi Pandemik H1N1 përhapet në të njejtën formë si gripi i zakonshëm. Gripi pandemik bartet prej njeriut tek njeriu përmes kontaktit me sperklat që vijnë nga teshtima apo kollitja e njerzve të infektuar. Prandaj është shumë e rëndësishme që ti kushtohet një vëmendje e veçantë higjienës personale të nxënësve nëpër shkolla.

Të gjithë nxënësit duhet ti lajnë duart me sapun dhe ujë të rrjedhshëm sa më shpesh që të jetë e mundur me kohëzgjatje për të paktën 20 sekonda. Është shumë e rëndësishme që nxënësit ti lajnë duart para se të fillojë ora e parë e mësimit në mënyrë që të zvogëlohet rreziku për kontaminimin e hapësirave shkollore. Tharja e duarve duhet të bëhet me faculeta njëpërdorimshe.

Në rast të pamundësisë për larjen e duarve duhet të përdoren dezinfektues personal të duarve me të cilat nxënësit duhet të pajisen. Nën kujdesin dhe mbikqyrjen e mësuesit të gjithë duhet ti dezinfektojnë duart para fillimit të orës së parë, dhe të paktën 3 herë gjatë periudhës që nxënësit vijojnë shkollën. Gjithashtu në shkollat me një numër të madh të rasteve të gripit duart duhet të pastrohen qdo herë para pauzës mësimore pasi që gjatë kohës së pauzës ekziston rreziku më i madh për transmetimin e virusit nga një nxënës tek tjetri.

Dezinfektimi i hapësirave shkollore

Virusi i gripit pandemik bartet edhe përmes kontaktit me sipërfaqet e kontaminuara. Virus mund të mbijetojë prej 6-24 orë në ambient të hapur. Prandaj është shumë e rëndësishme që të pastrohen rregullisht sipërfaqet me të cilat një numër i madh i nxënësve ka kontakt në qdo shkollë.

Të pastrohen rregullisht sipërfaqet me të cilat nxënësit janë në kontakt zakonisht siq janë: banjot, dorezat e dyerve dhe dritarëve, bankat, tastierat e kompjuterave, ndërprerësit e llampave, krojet.

Per arsye që gjate një dite një shkollë të vetme e frekuentojnë me qindra nxënës dhe duke marrë parasysh natyrën e transmetimit dhe kohën e shkurtër të inkubacionit këto sipërfaqe duhet te pastrohen pas qdo mbarimi të një turni mësimor. Në rastet kur kjo është e pamundur për shkak të mungesës eventuale të stafit, pastrimi duhet të bëhet së paku një herë në 24 orë. Në rastet kur edhe kjo është e pamundur atëherë të udhëzohen nxënësit që para fillimit të mësimit ti pastrojnë secili me alkool bankat e e veta.

Virusi i gripit pandemik H1N1 biofizikisht dhe biokimikisht nuk ndryshon nga virusi i gripit sezonal. Këto viruse janë mikroorganizmat me qëndrueshmërinë dhe rezistencën me të vogël ndaj dezinfektimit kimik. Prandaj të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen me detergjentët e zakonshem, alkool, zbardhues apo peroksid hidrogjeni dhe qdo dezinfektim tjetër me dezinfektues të gaztë është i panevojshem.

Dezinfektimi me dezinfektues të gaztë i ambienteve shkollore mund të bëhet vetem 1 herë në disa jave ose muaj për arsye financiare dhe logjistike, kjo bën që ky lloj i dezinfektimit përveq që nuk rekomandohet për arsye të mosefektivitetit, praktikisht të jetë i padobishëm sepse pastrimi dhe dezinfektimi i ambienteve shkollore duhet të bëhet së paku 1 herë në ditë.

Dezinfektimi me dezinfektues të gazët i ambienteve shkollore nuk rekomandohet dhe konsiderohet plotësisht joefektiv në parandalimin e gripit pandemik nga këto institucione: **US. Department of Health and Human Services, Centers for Disease Control and Prevention, California Department of Public Health, Iowa Department of Public Health.**

Metodat dhe Produktet me të cilat rekomandohet të bëhet dezinfektimi:

Produkti	Metoda për dezinfektim	Pastrimi i sipërfaqeve me prezencë sekrecioneve trupore
Zbardhuesi i zakonshëm (NaClO 5 %)	Të përzihet 1 sasi Zbardhues me 50 sasi ujë. Të lahen sipërfaqet dhe pastaj të lihen për tu terur.	Sipërfaqja së pari të lahet me detergjent e pastaj me zbardhues me metodën e treguar në të majtë. ←
Alkool 70%	Sipërfaqet të lahen duke përdorur kontakt të plotë.	Nuk rekomandohet pasi që alkooli inaktivizohet nga substancat organike.
Peroksid Hidrogjeni 0.5 %	Të përzihet një sasi Peroksid me 5 sasi uji. Të lahen sipërfaqet dhe pastaj të lihen për tu terur.	Sipërfaqja së pari të lahet me detergjent e pastaj me Peroksid me metodën e treguar në të majtë. ←

(Gjatë pastrimit personeli duhet të mbajë paisjet për mbrojtje personale siq janë dorëzat dhe maskat)

Monitorimi i vazhdueshëm i nxënësve për shenjat e gripit

Duke marrë parasysh numrin e madh të nxënësve në klasë, rreziku që gripit pandemik të përhapet është shumë i lartë. Të gjithë nxënësit duhet të këshillohen që të mos dalin në shkollë nëse kanë simptoma të gripit. Kjo duhet tu bëhet shumë e qartë edhe prindërve. Gjithashtu është shumë e nevojshme që të përcillet në mënyrë kontinuale shëndeti i nxënësve. Mësuesit duhet të njoftohen me shenjat dhe simptomat e gripit pandemik H1N1 në mënyrë që të jenë të aftë ti njohin këto shenja tek nxënësit e tyre. Në rast se mësuesi heton shenjat e gripit tek një nxënës ai duhet menjherë të lajmërojë prindërit dhe nxënësi nuk duhet të vijojë mësimin. Kjo duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos cënohet dinjiteti i nxënësit karshi nxënësve tjerë.

Informimi për Gripin pandemik

Duke marrë parasysh natyrën e përhapjes së gripit pandemik është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes menaxhmentit shkollor, mësuesve, nxënësve dhe prindërve, prandaj rekomandohet që shkolla të organizojë mbledhje të personelit për të diskutuar dhe komunikuar metodat parandaluese të gripit.

Çdo shkollë duhet të paiset me postera informues rreth Gripit pandemik H1N1 si dhe një rëndësi e veçantë duhet tu kushtohen edukimit të nxënësve rreth higjienës personale prandaj të gjitha materialet informuese duhet të përpilohen me gjuhë të thjeshtë që të kuptohen edhe nga fëmijët. Gjithashtu është e domosdoshme që menaxhmenti i shkollës ti ketë detalet kontaktuese të të gjithë prindërve në mënyrë që të arrihet komunikimi sa më i mirë në mes tyre.

Burimet

1. US Government H1N1, avian and pandemic flu information
2. Centers for Disease Control and Prevention (CDC)
3. California Department of Public Health
4. Iowa Department of Public Health
5. The U.S. Department of Education
6. Leeds Grenville & Lanark District Health Unit
7. British Columbia's H1N1 Pandemic Influenza Response Plan (2009)
8. Seattle Public Schools Emergency Management Plan

Dhjetor 2009

Grupi për Studime Mjekësore dhe Ekologjike

Adr. Gustav Mayer A1/5 Prishtinë, Kosovë.

Tel. +377 44 621 621 / +386 49 372 090 / +381 38 226 412

www.gsmesite.org